

Tiranë, më 30.06.2020

**K Ë R K E S Ë**

**KËRKUES:**

1. **Ines MULELLARI**, e bija e Robert-it, lindur më 02.10.1993, në Librazhd, me numër personal J36002060H, me adresë njoftimi: Sheshi “Avni Rustemi”, Rruga “Hoxha Tahsim”, Pallati “Vjero”, Apt. A17, Tiranë, me email: ines.mulellari@hotmail.com dhe nr.cel: (+355) 69 76 76 576.

2. **Mersi SHEHU**, e bija e Pajtim-it, lindur më 02.08.1996 në Peshkopi, me numër personal J65802089D, me adresë njoftimi: Sheshi “Avni Rustemi”, Rruga “Hoxha Tahsim”, Pallati “Vjero”, Apt. A17, Tiranë, me email: mersi\_shehu@yahoo.com dhe nr.cel: (+355) 69 33 77 605.

3. **Qëndresa Qytetare**, një organizatë jofitimprurëse e regjistruar me Vendimin Nr. 1120, datë 15.09.2016 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, me seli në adresën: Sheshi “Avni Rustemi”, Rruga “Hoxha Tahsim”, Pallati “Vjero”, Ap. A17, Tiranë, me email: qendresaqytetare@gmail.com dhe nr. cel: (+355) 67 48 25 149, përfaqësuar nga **Marash LOGU**.

4. Bashkalidhur kërkesës janë edhe **21 firma** të studentëve të cilët kanë mbaruar studimet master pranë Fakultetit Ekonomik, për vit rregjistrimi 2017-2018.

**OBJEKTI:**

Kërkesë për kontrollin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së Universitetit të Tiranës me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, sa i përket pajisjes me diplomat e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional”, të studentëve të regjistruar në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në vitin akademik 2017 – 2018.

**DREJTUAR:**            **Znj. Besa SHAHINI**  
Ministër i Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

**PËR DIJENI:**        **Z. Mynyr KONI**  
Rektor i Universitetit të Tiranës.

**Z. Dhori KULE**  
Dekan i Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës.

**BAZA LIGJORE:**    Neni 7 i Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”;  
Neni 16 i Ligjit Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore”;  
Vendimi Nr. 505, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”.

---

E nderuar Znj. Ministre,

Me kërkesën e datës 24.06.2020, ju kemi informuar në mënyrë të detajuar lidhur me problematikën e mospajisjes me diplomat e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional”, të studentëve të regjistruar në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në vitin akademik 2017 – 2018.

Konkretisht, ligji për arsimin e lartë dhe udhëzimet e nxjerra në zbatim të tij nga Ministri i Arsimit kanë parashikuar procedurën që duhet ndjekur për pajisjen me numër matrikullimi të studentëve të regjistruar pranë një institucioni të arsimit të lartë (IAL). Ligji dhe udhëzimet parashikojnë se IAL duhet të dërgojnë pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA) listën e studentëve të regjistruar në vitin akademik. QSHA brenda një afati të caktuar duhet t’i kthejë IAL listën e studentëve të dërguar së bashku me numrin e matrikullimit. Ky i fundit shërben për identifikimin e studentit nga fillimi i studimeve dhe deri në pajisjen e tij me diplomën përkatëse.

Në rastin konkret, rezulton se Fakulteti i Ekonomisë pranë Universitetit të Tiranës nuk i ka përcjellë listën e studentëve të regjistruar në ciklin e dytë të studimeve në vitin akademik 2017 - 2018 Rektoratit të UT-së, i cili më pas do t'ia përcillte QSHA, por ia ka dërguar drejtpërdrejtë QSHA-së. Kjo e fundit ka pajisur studentët me numrat e matrikullimit, ndërsa ka kërkuar që për disa studentë të plotësoheshin disa informacione shtesë. Rezulton se Rektorati i UT-së ka plotësuar të dhënat shtesë për disa studentë dhe ia ka përcjellë zyrtarisht QSHA-së, e cila ka bërë më pas pajisjen me numër matrikullimi edhe për këta studentë.

Pra, është e qartë se pavarësisht se Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës nuk ka respektuar detyrimin e saj për dërgimin e listës së studentëve të regjistruar pranë Rektoratit të UT-së, dërgimi në mënyrë të drejtpërdrejtë e ka realizuar qëllimin e ligjshëm, pasi QSHA ka pajisur studentët me numër matrikullimi. Kjo do të thotë që problematika e ngritur nga ana e Rektoratit sa i përket pajisjes ose jo të studentëve me numër matrikullimi nga QSHA nuk përputhet me realitetin, pasi QSHA ka konfirmuar pajisjen e studentëve me numër matrikullimi, dhe nuk ekziston asnjë pengesë për pajisjen e studentëve me diplomën përkatëse.

Nenet 75 dhe 91 të ligjit për arsimin e lartë, nenet 92, 110 dhe 125 të Statutit të UT, dhe neni 63 i Rregullores së UT-së parashikojnë se çdo student në përfundim të studimeve ka të drejtë të pajiset me diplomën përkatëse. Pajisja me diplomë nga IAL kërkon përmbushjen e të gjitha detyrimeve mbi studentin, që do të thotë se ky i fundit duhet të ketë frekuentuar rregullisht leksionet dhe seminarët, duhet të dhënë të gjitha provimet, duhet të ketë kryer mbrojtjen e diplomës, duhet të ketë paguar tarifën vjetore, duhet të ketë dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me diplomë dhe pagesën e kartonit të diplomës. Vetëm pasi verifikohet përmbushja në mënyrë kumulative e kërkesave të mësipërme, Fakulteti dhe Universiteti janë të detyruara të pajisin studentin me diplomën përkatëse.

Në rastin konkret, studentët e Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, të regjistruar në ciklin e dytë të studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional” kanë përmbushur të gjitha detyrimet dhe kërkesat për pajisjen me diplomë. Megjithatë, kjo nuk ka ndodhur si rezultat i mosmarrëveshjeve të krijuara ndërmjet Dekanatit të FEUT dhe Rektoratit të UT lidhur me pajisjen e studentëve me numrat e matrikullimit nga QSHA. Por, kjo problematikë tashmë është e tejkaluar pasi pavarësisht parregullsive në procedurë, QSHA ka pajisur tashmë studentët me numrat e

matrikullimit. Në këto kushte, nuk ekziston asnjë pengesë ligjore apo objektive që Universiteti i Tiranës të pajisë studentët me diplomat e fituara.

Nga korrespondenca dhe komunikimet e vazhdueshme me Dekanatin e Fakultetit të Ekonomisë, UT jemi informuar se diplomat i janë dërguar për nënshkrim Rektorit të UT-së, por nga ana e tij nuk është marrë akoma asnjë përgjigje. Nënshkrimi i diplomave nga Rektori i UT për të gjitha programet e studimeve që ofron Universiteti i Tiranës, është një detyrim ligjor që buron nga neni 34 i Statutit të UT-së, cka do të thotë se Rektori është i detyruar ligjërisht për të proceduar personalisht me nënshkrimin e diplomave të studentëve. Mospërbushja e këtij detyrimi passjell përgjegjësi ligjore. Prandaj, studentët kanë kërkuar nga Rektori i UT-së që t'i japë zgjidhje të menjëhershme problematikës së krijuar, duke nënshkruar diplomat dhe bërë dorëzimin e tyre brenda një afati 10 (dhjetë) ditor nga momenti i dorëzimit të kësaj kërkesë.

Në vijim të kësaj kërkesë, Dekanati i Fakultetit të Ekonomisë, Universiteti i Tiranës me shkresën Nr. 595/1 Prot., datë 25.06.2020 është shprehur se kërkesa e studentëve është e ligjshme, pasi ata kanë plotësuar detyrimet akademike, financiare dhe kanë dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm për pajisjen me diploma. Ndërsa, lidhur me mospajisjen e studentëve me diploma, Dekanati është shprehur se kjo ka ardhur si rezultat i veprimeve të paligjshme të Rektorit të UT, i cili refuzon nënshkrimin e diplomave të përcjella nga Fakulteti i Ekonomisë.

Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë me shkresën Nr. 3447/1 Prot., datë 25.06.2020 është shprehur se respekton parimin e autonomisë së institucioneve të arsimit të lartë. Megjithatë, në zbatim të ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor” kërkon zgjidhjen e menjëhershme të çështjes së nënshkrimit të diplomave të Fakultetit të Ekonomisë në Universitetin e Tiranës dhe dorëzimin e diplomave përkatëse. Ndërsa, lidhur me respektimin e procedurave për lëshimin e numrave të matrikullimit, Ministria ka konsideruar se është një çështje e brendshme e universitetit.

Së fundmi, me shkresën Nr. 1839/2 Prot., datë 29.06.2020, Rektori i Universitetit të Tiranës është shprehur se Dekani i Fakultetit të Ekonomisë, UT dhe Drejtoresha e Qendrës së Shërbimeve Arsimore kanë vepruar në shkelje të ligjit për arsimin e lartë dhe udhëzimeve të Ministrisë së Arsimit, sa i përket pajisjes së studentëve me numrat e matrikullimit. Kësisoj këto kartona (jo

diploma), nuk mund të nënshkruhen nga Rektori i Universitetit të Tiranës. E vetmja zgjidhje për Rektoren mbetet dërgimi i listës përfundimtare të studentëve të regjistruar me të dhënat e tyre për matrikullim.

Përgjigjet e Rektorit të Universitetit të Tiranës dhe Dekanatit të Fakultetit të Ekonomisë, UT në thelb përforcojnë qëndrimet e mëparshme të palëve, pa ofruar asnjë zgjidhje reale për studentët. Secila palë akuzon palën tjetër për paligjshmëri dhe fajësi në shkaktimin e këtij problemi, por asnjëra palë nuk shpreh vullnetin, që në emër të interesit më të lartë të studentëve, të ofrojë zgjidhje të shpejtë dhe efikase. Në këto kushte, kur të dyja palët akuzojnë njëra-tjetrën për është e nevojshme ndërhyrja ligjore e një pale të tretë, për të konstatuar paligjshmëritë e kryera, si dhe marrjen e masave të nevojshme, me qëllimin e vetëm **pajisjen e studentëve me diploma në një kohë sa më të shkurtër.**

Neni 7, paragrafi i dytë, gërma “e” parashikon “2. Ministria përgjegjëse për arsimin ka këto kompetenca: e) kontrollon pajtueshmërinë e veprimtarisë së institucioneve të arsimit të lartë me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi”. Kjo do të thotë se Ministria e Arsimit është përgjegjëse për garantimin e ligjshmërisë në universitetet publike dhe private. Në këtë kuptim, ajo mund të ngrejë grupe pune, të cilat kryejnë kontrole, konstatojnë parregullsi dhe kërkojnë marrjen e masave. Në rastin konkret, Ministria e Arsimit, si institucioni përgjegjës për garantimin e ligjshmërisë, mbart detyrimin ligjor për të kontrolluar zbatimin e akteve ligjore dhe nënligjore nga Universiteti i Tiranës, dhe në rast moszbatimi marrjen e masave të nevojshme, **për të garantuar interesin më të lartë të studentëve: pajisjen e tyre me diplomat e studimeve.**

Prandaj, duke pasur parasysh sa më sipër, bazuar në nenin 7 të ligjit Nr. 80/2015, paragrafi i dytë, gërma “e”, nenin 16 të ligjit Nr. 90/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore” dhe Vendimin Nr. 505, datë 13.09.2017 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e fushës së përgjegjësisë shtetërore të Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë”, përfundimisht,

**KËRKOJMË:**

1. Kontrollin e pajtueshmërisë së veprimtarisë së Universitetit të Tiranës me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, sa i përket pajisjes me diplomat e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional”, të studentëve të regjistruar në Fakultetin e Ekonomisë, Universiteti i Tiranës në vitin akademik 2017 – 2018.
2. Marrjen e masave të nevojshme për pajisjen në një kohë sa më të shpejtë të studentëve me diplomat e studimeve “Master i Shkencave” apo “Master Profesional”.


Duke ju falëndëruar paraprakisht, mbetemi në pritje të përgjigjes Tuaj.

Me konsideratë,


**Ines MULELLARI**

()

**Mersi SHEHU**

()

**Marash LOGU**

()